



**UNIVERSITETI
KADRI ZEQA
UNIVERSITY**

UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA
FAKULTETI I EDUKIMIT

PUNIM DIPLOME

Gjilan, 2023

UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPERTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE
PROGRAMI: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

TEMË E MASTERIT

Tradita në romanet Bardha e Temalit (Pashko Vasa) dhe Sikur të isha djalë (Haki Stërmilli) - perceptimi nga nxënësit e klasës XI

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Merxhan Avdyli

Kandidati:

Xhemile Selmani- Syla

Përmbajtja

1. ABSTRAKTI	3
2. ABSTRACT	4
3. HYRJE	8
4. METODOLOGJIA	10
PYETJET HULUMTUESE	11
SHQYRTIMI I LITERATURËS	12
KAPITULLI I	13
1.1 DY VEPRA TË NDRYSHME - NJË BURIM FRYMËZIMI	13
2.1. VEPRAT E PASHKO VASËS	16
2.2. VEPRA E HAKI STËRMILLIT	20
Kapitulli II	27
1. ELEMENTE TË TRADITËS	27
Kapitulli III	36
ANALIZA E TË DHËNAVE	36
PËRFUNDIME	47
ANEKSI 1 Pyetësor për temën e Masterit	51

1. ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi ka qenë analizimi në mënyrë të hollësishme i veprave “Bardha e Temalit” të Pashko Vasës dhe “Sikur të isha djalë” të Haki Stërmillit. Analiza është fokusuar në traditat shqiptare dhe ndikimin e tyre në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave tradicionale shqiptare tek nxënësit e shkollave të mesme. Qëllim i cili tregon kryesisht për rolin e traditës, sa ishte i pranishëm dhe si e kanë trajtuar këta autorë traditën si temë në veprat e tyre.. Rreth këtij punimi, është krijuar një pyetësor për të mbledhur të dhëna mbi këndvështrimet e këtyre veprave letrare në mendimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj traditave shqiptare. Gjithashtu, u përdor edhe analizë sasiore, duke marrë për bazë rezultatet nga përgjigjet e pyetësorit. Në pyetësor morën pjesë 55 nxënës të klasave të XI-ta të SHMLM “Kongresi i Manastirit” në qytezën Pozheran të Komunës së Vitisë.

Nga numri i përgjithshëm sa kanë marrë pjesë në përgjigjet e tyre të këtij pyetësori, rezultojnë se 64.21% janë pajtuar, 20.83% janë pajtuar pjesërisht, 10.41% nuk janë të sigurtë dhe 4.50% nuk janë pajtuar. Bazuar në këto përqindje, mbi 64.21% e të anketuarve janë pajtuar, ndërsa vetëm 4.50% nuk janë pajtuar me përmbajtjet e pyetjeve të shtruara, të cilat kanë pasur për qëllim analizën e perceptimit të nxënësve në këtë punim magjistrature.

Rezultatet e këtij punimi të masteri kryesisht shërbejnë për mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme por ky punim masteri mund të jetë edhe dobishëm për studiuesit e folklorit dhe traditave kombëtare, për antropologët dhe prindërit, për të bartur dhe mbajtur gjallë këto tradita tek gjeneratat e ardhshme. Për më tepër, ky punim masteri mund të ofrojë të dhëna shtesë për të kuptuar se si veprat letrare që trajtojnë tema që kanë në fokus traditat kombëtare mund të shërbejnë si një mjet për të ngritur vetëdijen për ruajtjen dhe kultivimin e këtyre traditave.

2. ABSTRACT

The purpose of this study was to analyze in detail the works "Bardha e Temalit" by Pashko Vasa and "Sikur te isha djale" by Haki Stërmilli. The analysis is focused on Albanian traditions and their impact on the preservation and cultivation of traditional Albanian values among high school students. The aim which shows mainly the role of tradition, how much it was present and how these authors have treated tradition as a theme in their works.. About this paper, a questionnaire has been created to collect data on the perspectives of these literary works in the opinions of high school students towards Albanian traditions. Also, quantitative analysis was used, based on the results from the questionnaire responses. 55 students of the 11th grades of SHMLM "Monastery Congress" in the town of Pozheran of the Municipality of Vitia participated in the questionnaire.

From the total number of participants in their answers to this questionnaire, it turns out that 64.21% agreed, 20.83% partially agreed, 10.41% were unsure and 4.50% disagreed. Based on these percentages, over 64.21% of the respondents agreed, while only 4.50% disagreed with the contents of the questions asked, which were aimed at analyzing the perception of the students in this master's thesis.

The results of this master's thesis mainly serve for teachers and high school students, but this master's thesis can be useful for researchers of folklore and national traditions, for anthropologists and parents, to carry and keep these traditions alive in future generations. . Moreover, this master's thesis can provide additional data to understand how literary works that deal with topics that focus on national traditions can serve as a tool to raise awareness for the preservation and cultivation of these traditions.

DEKLARATË

Deklaroj se kjo temë është rezultat i punës sime të pavarur hulumtuese. Të gjitha burimet e përdorura, duke përfshirë materialet e shkruara ose vizuale, janë pranuar dhe cituar siç duhet. Çdo ide, frazë ose fjali e huazuar nga vepra të tjera shoqërohet me atribuimin e duhur autorëve përkatës. Unë pohoj se kjo temë nuk përmban plagjiaturë dhe se jam mbështetur parimet e integritetit akademik gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit.

Emri dhe Mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Datë _____

MIRËNJOHJE

Dëshiroj të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë ata që kanë kontribuar në përfundimin e kësaj teme të magjistraturës. Falënderoj thellësisht Prof.Asoc.Dr. Merxhan Avdylin, për udhëzimet, mbështetjen dhe njohuritë e tij të çmueshme, këshillat gjatë gjithë procesit të kërkimit. U jam gjithashtu mirënjohëse të gjithë kolegëve të mi për shkëmbimin e përvojave që kemi pasur

gjatë kësaj periudhe studimi.

Falënderime edhe për profesorët e këtij institucioni arsimor të çmuar, që gjatë studimeve të mija kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të ndarë përvojat e tyre të çmuara, duke shkëmbyer dije pa fund.

Në fund, do të doja të falënderoja familjen dhe miqtë e mi për inkurajimin dhe mirëkuptimin e palëkundur gjatë fazave sfiduese të kësaj teme. Mbështetja e tyre ka qenë e rëndësishme në përfundimin me sukses të këtij hulumtimi.

Kjo temë është një kulm i përpjekjeve bashkëpunuese dhe mbështetjes nga profesionistët dhe institucionet e lartpërmendura. Unë jam vërtet mirënjohës për kontributin e tyre në këtë përpjekje akademike."

3. HYRJE

Krahasimi, ndikimi, nxitja, dallimet si dhe ngjashmëritë, mund të ndodhen brenda një letërsie një epike letrare, dy shkrimtarëve, veprave, arteve dhe veprimtarive tjera njerëzore.

Ajo që merret me studimin e tyre është Letërsia Krahasimtare, e cila është përpjekje intelektuale dhe punë metodike e huazimit të analogjive dhe lidhjeve, ngjashmërive, dallimeve dhe ndikimeve, të dy letërsive, të dy shkrimtarëve, të dy veprave, por me kusht që të jenë jashtë kufijve të një kulture kombëtare.

Kështu, nëse nisemi nga vetë titulli i punimit të diplomës “Tradita” si temë në veprat e autorëve tanë të njohur V. Pashës, H. Stërmilli gjegjësisht veprave “Bardha e Temalit” , “ Sikur t’isha djalë” , qartësojmë qëllimin tonë i cili tregon se në vazhdim të këtij punimi do të flasim kryesisht për rolin e traditës, sa ishte e pranishme dhe si e kanë trajtuar këta autorë traditën si temë në veprat e tyre. Për shkrimtarët në fjalë besoj se jemi mjaft të informuar dhe dimë se zënë një vend të merituar në historinë e letërsisë shqiptare.

Qëllimi im në këtë punim është që t’i vë në pah dhe t’i analizoj motivet nga tradita shqiptare që i hasim në këto vepra. Gjithashtu këtë temë e kam zgjedhur jo sepse nuk është studiuar tradita tek ne por, nuk ka qasje të mjaftueshme në fushën krahasuese, dhe me qëllim që t’i qasem në një mënyrë pak më ndryshe se ata që kanë studiuar deri më tani traditën shqiptare, pra në mënyrë krahasuese.

Në temën që kam zgjedhur, në fillim kam dhënë disa të dhëna për autorët të cilët hyjnë në mesin e shumë autorëve që i takonin Rilindjes Kombëtare dhe periudhës së Pavarësisë, veprimtaria e të cilëve hyn në letërsinë e Rilindjes Kombëtare dhe atë të pavarësisë. Këtu do të flas për krijimtarinë e autorëve, ku autorët e kësaj periudhe kishin barrën kryesore intelektuale për t’i udhëhequr shqiptarët drejt çlirimit. Pastaj do të flas në pika të shkurtra për dy veprat duke u munduar të sjell pak informacion lidhur me përmbajtjen e veprave. Të dyja këto vepra janë të larmishme me tema por emta e tyre kryesore është tema e dashurisë. Në to ngërthehen edhe tema

tjera nga tradita siç janë : besa shqiptare, dashuria për atdheun, nderi, të cilat zinin vend të parë në jetën e tyre etj.

Pra, ajo që ne do të shqyrtojmë më gjerësisht është prezenca e këtyre elementeve të traditës, në këto vepra.

Autorët në veprat e tyre paraqesin traditën shqiptare me të gjitha të mirat e të këqijat e saj. Po ashtu dhe pyetëtori që do të përgatitet si pjesë e hulumtimit sasior, do të përfshijë pyetje që ndërlidhen kryesisht me përvojën e nxënësve të marrë nga veprat ‘Bardha e Temalit’ dhe ‘Sikur të isha djalë’, duke tentuar të kuptojmë se si dhe sa kanë ndikuar për njohjen e traditave shqiptare, a kanë arritur të vërejnë ndryshime, t’i kuptojnë më mirë dhe t’i përqafojnë dallimet e gjeneratave, po ashtu ta kuptojnë dhe më mirë rolin e gruas shqiptare nëpër vite .

Te të dy veprat tradita është ajo që ua shuan ëndrrat të rinjve shqiptarë të kohës kur janë shkruar këto vepra, pikërisht tradita është ajo që ua mohon të drejtat për zgjedhjen e lirë. Pastaj paraqesin jetën e femrës shqiptare ku asgjë nuk varej nga vetja e saj por, nga ajo që ia caktonte familja, si e drejta për martesë, për shkollim etj. Vajza shqiptare duhej të bënte fëmijë që të ruante trashëgiminë pra, kështu duhej të jetonte femra shqiptare sipas traditës. Nuk pyeste kush për ëndrrat e saj le të mos flasim për të drejtat humane. Dhe kjo traditë si shenjë e pakënaqësive dhe e mos realizimit të ëndrrave të tyre i shtyn të rejat e të rinjtë shqiptarë drejt tragjedisë e cila në shumë raste bëhet e pashmangshme.

Gjatë punimit të diplomës së masterit kam përdorur formën përshkuese dhe krahasuese duke u munduar që struktura kompozicionale e punimit të jetë sa më e përkryer. Duke pasur parasysh traditën që trajtohet në veprat në fjalë e në përgjithësi, do të mundohem të paraqes, në mënyrë të veçantë , në pika të shkurtër elementet e traditës shqiptare që janë spikatur në këto vepra.

Gjithashtu, kam hasur edhe në vështirësi gjatë mbledhjes së materialit të cilat i kam tejkaluar por që më kanë marrë kohë, dhe pasi që kjo temë nuk është studiuar ndonjëherë më parë në rrafshin krahasimtar, dhe nuk kam pasur shembull që të ndjek, ka qenë pak më e vështirë për mua.

Megjithatë, unë mendoj që rezultatet do të jenë të frytshme dhe puna ime do të shpërblehet. Nga kjo temë pres që atyre që do të kenë mundësi ta lexojnë t'iu jap një pasqyrë të qartë të traditës shqiptare më të mirat e të metat e saj.

4. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur metoda sasiore dhe kryesisht ajo cilësore në rastet ku ka gjetur përdorim. Veprat “Bardha e Temal” dhe “Sikur të isha djalë” u analizuan lidhur me trajtimin e elementit të traditave shqiptare. Po ashtu kam shfaqur një pasqyrim të gjerë rreth asaj se a është trajtu mjaftueshëm tradita shqiptare të romanet “Bardha e Temalit” dhe “Sikur të isha djalë”, bazura në kritika dhe në librat del një rezultat i kënaqshëm rreth trajtimit të temës së traditës shqiptare nga këta autor. U analizuan burime të ndryshme, kryesisht nga autorë vendas, si libra dhe artikuj në revista letrare. Për të përfunduar analizën sasiore të kësaj teme, u krijua një pyetësor me 10 pyetje për të vlerësuar ndikimin e këtyre veprave në traditat shqiptare. Pyetësi kishte për qëllim mbledhjen e mendimeve të nxënësve që kishin lexuar këto dy vepra si pjesë e kurrikulës së gjuhës shqipe, rreth vlerave të traditës shqiptare. Në këtë pyetësor morën pjesë 55 nxënës nga klasa e 11-të SHMLM "Kongresi i Manastirit" Pozheran, nga të cilët 25 ishin femra dhe 30 meshkuj. Pyetësi është zhvilluar në formën elektronike gjatë periudhës nga qershori deri në gusht 2023. Pyetësi u përpoq të merrte përgjigje nga nxënësit e shkolles së mesme se si i perceptojnë ata traditat shqiptare, nëse këto vepra kanë ndikuar pozitivisht në të kuptuarit e tyre për traditat shqiptare ndër vite.

Metodat e përdorura në këtë punim si ajo sasiore ka nxjerrë në pah mendimet e nxënësve me anë të cilave trajtohet ky punim, dhe nga ana tjetër neperjet metodave sasiore sasiore tregohet ndikimi i këtyre veprave në ruajtjen e vlerave të traditave shqiptare. Ka mundur të jetë më i madh numri i të anketuarve, që hulumtimi të jetë edhe më i vërtetuar. Me këta pjesëmarrës sa janë, është rezultat i kënaqshëm.

PYETJET HULUMTUESE

Sa i është dhënë rëndësi e vecantë traditave shqiptare nga autorët Pashko Vasa dhe Haki Stërmili në veprat “Bardha e Temalit” dhe “Siku të isha djalë” ??

Nga këto vepra a kanë ndikuar traditat në ruajtjen e vlerve të vjetra tek nxënësit e shkollës së Mesme ??

HIPOTEZAT

Në romanet “Bardha e Temalit” dhe “Siku të isha djalë” iu është dhënë rëndësi e vecantë dhe e konsiderushme traditave shqiptare nga autorët Pashko Vasa dhe Haki Stërmilli.

Për mes veprave “Bardha e Temalit” dhe “Siku të isha djalë” elementi i traditave shqiptare ka pasur ndikim pozitiv të nxënësve të shkollave të mesme, për ruajtjen e vlerave të vjetra.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Qëllimi i shqyrtimit të literaturës së kësaj teme të magjistraturës është të ofrojë një përmbledhje të literaturës që është dhe kërkimit të kryer mbi temën e traditës, e cila është përgjithshme dhe e veçantë për çdo komb meqë përfaqëson identitetin e atij kombi.

Kultivimi i traditës në shoqëri ka ekzistuar në çdo periudhë kohore dhe në çdo hapësirë, dhe vazhdon të jetë e rëndësishme për çdo familje shqiptare. Hulumtimi synon të shërbejë dhe të japë një kontribut të vogël në ndërgjegjësimin e shoqërisë, përafrimin dhe njohjen e dallimeve që përfaqësojnë dy breza të ndryshëm. Analiza rrjedh kryesisht nga veprat “E bardha e Temalit” e Pashko Vasës dhe “Sikur të isha djalë” e Haki Stërmillit, si dhe nga pyetëtori i bërë me nxënësit e gjimnazit SHMLM “Kongresi i Monastirit”. Literatura tjetër e përdorur për këtë hulumtim ishte "E drejta zakonore shqiptare" (trashëgimia kulturore juridike) nga Avdyl Hoxha, Rexhep Maksutaj dhe "Kanuni i Lekë Dukagjinit" nga Shtjefën Gjeçovi.

KAPITULLI I

1.1 DY VEPRA TË NDRYSHME - NJË BURIM FRYMËZIMI

Pashko Vasa ka dhënë kontribut të madh në edukimin dhe arsimimin e popullit në periudhat më të vështira të tij. Ky autor i takon brezit të shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare që në letërsi quhej periudha e Romantizmit shqiptar. Ndërsa Haki Stërmilli i takon një periudhe të mëvonshme e quajtur si periudha e Pavarësisë ku edhe ai dha kontributin e tij midis prozatorëve të paktë të kësaj periudhe.

Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua si pjesë e pandarë e lëvizjes politiko-shoqërore e kulturore për çlirimin e vendit nga zgjedha e huaj. Kjo lëvizje, që nis nga mesi i shekullit XIX dhe arrin deri në vitin 1912, quhej Rilindje Kombëtare. Kjo është kryesisht letërsi patriotike me frymë demokratike e popullore. Tema kryesore e saj ishte dashuria për atdheun dhe popullin, evokimi i së kaluarës heroike dhe lufta për çlirimin kombëtar e shoqëror. Kushtet historike që e përcaktuan zhvillimin e saj, ishin kryengritjet e vazhdueshme kundër pushtuesve osman, lufta për pavarësi dhe të qarqeve shoviniste fqinje. Letërsia e Rilindjes pati një drejtim iluminist e në periudhën e fundit edhe vepra realiste, por në thelbin e vet ajo ishte një letërsi romantike. Në veprat më të mira të saj u shprehen ideale të larta kombëtare, malli dhe dashuria e zjarrtë për mëmëdheun, krenaria për të kaluarën e lavdishme të popullit shqiptar dhe ëndrra për ta parë Shqipërinë e lirë, të pavarur e të lulëzuar.

Letërsia që shoqëron këtë periudhë të rëndësishme të zhvillimit kombëtar shqiptar, është letërsi romantike. Në të gjithë botën e qytetëruar lindja e romantizmit ka shoqëruar lindjen e

nacionalizmit. Romantizmi¹, duke dalë nga lëvizjet e mëdha të Evropës Perëndimore, u përhap dalëngadalë edhe në Evropën e Lindjes dhe të Juglindjes, në kohën kur Perëndimi që e lindi, po e braktiste dhe kur atje kishin dalë të tjera rryma letrare si: realizmi, natyralizmi, e simbolizmi. Kjo letërsi lindi së pari, si trumbetuese e madhështisë kombëtare të popujve. Malli dhe nostalgjia për të kaluarën e shtynë autorin romantik të gjurmonte vise të largëta dhe epoka të largëta të historisë.

Por sigurisht që ky drejtim pati cilësitë e veta të veçanta në vende të ndryshme. Kështu në Shqipëri, nga rrethanat specifike të saj, ideja kombëtare u bë një nga cilësitë kryesore të poezisë romantike, kjo edhe sepse në këtë truall mungonte themeli filozofik i poezisë, si dhe kulti i individit në lidhje me mjedisin. Prandaj nuk ishte aq i ndjeshëm largimi i poetit romantik nga realiteti, fluturimi i tij në vise të largëta, si tipar kryesor i romantizmit. Romantikët tanë i kënduan jo natyrës në përgjithësi, por natyrës shqiptare, duke e himnizuar atë, për të ngjallur dashurinë dhe krenarinë për Shqipërinë.

Heroi romantik i Rilindjes është hero i luftëtar që sakrifikon gjithçka për lirinë e atdheut, si dhe njeriu i thjeshtë bujku, fshatari, bariu, që përpiqet të gjejë gëzimin e jetës duke punuar në atdheun e tij.

Në letërsinë e Rilindjes iu kushtua vëmendje e veçantë problemeve filozofike dhe etike si: problem i së drejtës për liri dhe lumturi të individit, i moralit të njeriut, i jetës dhe i vdekjes, etj. Ashtu si romantikët evropianë, edhe romantikët shqiptarë iu drejtuan folklorit. Duke u mbështetur në të, romantizmi shqiptar fitoi veçoritë dhe origjinalitetin kombëtar.

Letërsia e Rilindjes solli një zhvillim të dukshëm të gjinive të llojeve letrare. Kreun e vendit e zuri poezia, veçanërisht poezia lirike, më pak u zhvillua proza, tregimi, romani, novela, dramaturgjia.

Gjatë Rilindjes mori hov publicistika, që luajti rol të rëndësishëm në çështjen kombëtare. Letërsia romantike e Rilindjes kishte karakter²:

¹ Kodra K, Grup Autorësh, 2000, Letërsia Shqipe, Prishtinë, faqe 15

² Kodra K, Grup Autorësh, 2000, Letërsia Shqipe, Prishtinë, faqe 16

Kombëtar: u bë shprehëse e drejtpërdrejtë e frymës, e racës dhe e identitetit kulturor shqiptar me anën e gjuhës së përbashkët.

Politik: u angazhua plotësisht në problemet aktuale, politike të vendit.

Popullor: u mbështet në shijet dhe aspiratat e popullit shqiptar.

Iluminist : besoi në fuqinë e fjalës për emancipimin dhe përparimin shoqëror të vendit.

Pashko Vasa është autor i një vargu veprash me karakter politik e historik, në të cilat mbrojtë çështjen e popullit shqiptar, të drejtën e tij për të rrojtur i lirë dhe i pavarur.

Pashko Vasa ka hyrë në letërsinë e Shqipërisë si njëri prej udhëheqësve, ideologëve dhe propaganduesve më kryesorë të lëvizjes së çlirimit nga Turqia, ndërsa në letërsinë shqiptare ka zënë një vend nderi me poezinë e famshme “O moj Shqypni”, që është manifesti më i fuqishëm poetik i idealeve të Rilindjes Kombëtare.

Pashko Vasa u lind në Shkodër më 1825 dhe u rrit në qytetin e lindjes. Për sa i përket arsimimit ai ishte autodidakt, tërë jetën u dallua si njeri me horizont kulturor, që zotëronte me përsosmëri shumë gjuhë. Shpejt e braktisi atdheun, por mbeti i pranishëm me mbështetjen morale dhe intelektuale në ngjarjet më të mëdha të historisë sonë. Pas një përvoje të shkurtër në konsullatën Britanike të Shkodrës, në moshën 22 vjeçare u largua për në Itali, ku mori pjesë në kryengritjen e popullit Italian për një shtet unik e të pavarur nga zgjedha austriake. Atje ai shërbeu si oficer kalorësie. Meqenëse ishte shqiptar, trupat austriake në Itali e detyruan të largohej për në Stamboll.

Ai qëndroi në krye të përpjekjeve për themelimin e shoqërive kulturore shqiptare dhe nëpër hartimin e një alfabeti të shqipes. Pashko Vasa nuk pushoi për asnjë çast luftën diplomatike në mbrojtje të drejtave tokësore të shqiptarëve me anën e memorandumeve që u dërgonte Fuqive të Mëdha³. Në ato memorandum janë përmbledhur idetë kryesore që autori i shtjelloi në veprën

³ Kodra K, Grup Autorësh, 2000, Letërsia Shqipe, Prishtinë, faqe 103

“Shqypnija dhe Shqypetarët” (1879) dhe, veçanërisht, në veprën “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqypetarët” (1879).

Vdiq në Bejrut më 1892, duke mbetur shqiptar me shpirt e me vepra gjer në fund.

2.1. VEPRAT E PASHKO VASËS

Pashko Vasa është anëtar i atij brezi shkrimtarësh që themeluan letërsinë kombëtare shqiptare . Në të njëjtën kohë ai është edhe pjesëtar i atij brezi shkrimtarësh shqiptarë që punuan e krijuan jashtë atdheut, çka ndikoi në konceptimet romantike ndaj problemeve shqiptare.

Pashko Vasa përveç poezisë, pati meritën se e pasuroi traditën letrare shqiptare edhe me eseistike , ku dallohet si një mjeshër dhe stilist mjaft i mirë, pavarësisht se një pjesë e tyre u shkrua në gjuhë të huaja.

Veprat më të rëndësishme të Pashko Vasës janë: “Burgimi im” 1850, “Trëndafila dhe Gjemba” 1873, “Shqypnija dhe shqypetarët” 1879, “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqypetarët”1879, “Mori shqypni e mjera shqypni” 1880 dhe romani “Bardha e Temalit”1890.

Vepra më e rëndësishme e Pashko Vasës është pa dyshim romani “Bardha e Temalit” të cilin e shkroi më 1890 në Paris. Vepra në fjalë flet për një ngjarje tragjike të vendosur në Shqipërinë e veriut në vitin 1842 e cila ngjarje përputhet edhe me kohën në të cilën jetoi shkrimtari.

Është ndoshta i pari roman i shkruar nga një shqiptar. Ai paraqet botën shqiptare me gjeografinë, etnografinë dhe mentalitetin e saj. Kjo vepër dëshmon për një shkrimtar tërësisht të formuar dhe me aftësi të dallueshme. Romani është shkruar me një frëngjishte të përsosur dhe me një stil bashkëkohor. Aty të bie menjëherë në sy erudicioni i madh i shkrimtarit , jo vetëm në lidhje me botën por edhe me filozofinë dhe letërsinë botërore: gjejmë idetë liberale të filozofit anglez Spenser, vargje të Dante Alighierit etj.

Romani “Bardha e Temalit” nxjerr në pah raportin ndërmjet individit dhe shoqërisë së pa civilizuar, e cila me normat e saj të ngurta shtyp me të gjitha mjetet e lirinë e individit. Bardha⁴ e Temalit në radhë të parë është roman dashurie, trajtimi i një teme të vjetër sa edhe vetë njeriu. Mirëpo, njëherësh është edhe një pasqyrë e shoqërisë shqiptare të shekullit të kaluar, më mirë të themi e një pjese të kësaj shoqërie, e Shqipërisë Veriore, ku kishte vazhduar të ruhej rregullimi fisnor dhe traditat e lashta primitive.

Bardha, vajzë e një familjeje “borgjeze”⁵ të Shkodrës i nënshtrohet vullnetit të prindërve për t’u martuar me Lulin e Temalit, nga një familje bajraktarësh të Malsisë. Bardha, vajzë e bukur nga qyteti detyrohet të ballafaqohet me karakterin tepër barbar të Lulit dhe të së ëmës së tij. Ajo rastësisht njihet me Aradin, një bashkëmoshatar të vetin, dhe në atë cast lind dashuria përrallore ndërmjet tyre, një dashuri aq e madhe sa nuk përshkruhet me fjalë. Por gjërat janë më tepër të komplikuar se kaq. Aradi i takon një familjeje që ka helmuar të bijën e vet për një flirt dhe vetë ai ka vrarë në një pritë atë që guxoi të flirtonte me të motrën. Në këtë mënyrë subjekti ndërlikohet, bëhet më tërheqës dhe dalëngadalë të çon te tragjedia.

Mbeten dy zgjedhje të mundshme: ose Luli të vritet nga Aradi dhe të realizohet një fund i lumtur me bashkimin e dy të dashuruarve, ose e kundërta: të vritet Bardha nga xhelozia e Lulit dhe çdo gjë të marrë fund trishtueshëm. Fatkeqësisht që në roman fiton alternativa e dytë.

Personazhi kryesor i romanit Bardha na paraqet një personazhe tipike romantike. Ajo nuk merr pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në aksionin e veprës, është pasuese e aksionit. Gjithçka që ndodh përjetohet përbrenda saj. Me Bardhën autori na dha personazhin e një gruaje të civilizuar, që në një kuptim simbolizon fillimin e një shoqërie të emancipuar. Bardha vritet në gjumë nga e vjehrra e vet, duke lënë më pas tek lexuesi një brengë të thellë.

Megjithatë, me rastin e analizës së kryeprogonistes⁶ së romanit nuk duhet harruar as faktin se Bardha jeton në një ambient specifik, se ajo nuk e ka në dorë fatin e saj dhe se është më shumë një lodër në duart e të tjerëve. Përveç kësaj Bardha paraqitet vetëm në relacionin e dashurisë së saj

⁴ Bardha e Temali, Pashko Vasa fq.11

⁵ Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Capaliku, Letërsia shqipe fq.17

⁶ Bardha e Temalit, Pashko Vasa, fq.15

ndaj Aradit . Aspektet e tjera të jetës së këtij personazhi janë lënë anash, ngase në të vërtetë asgjë nuk ndodh në jetën e kësaj gruaje para se të takohet me Aradin, ditët e saj ishin të zbrazëta, monotone, dëshirat të ndrydhura në një shoqëri primitive.

Mirëpo nëpërmjet Bardhës autori është përpjekur ta pasqyrojë fatin e gruas shqiptare në përgjithësi. Ai këtu ka ndërthurë një varg idesh e problemesh për shoqërinë shqiptare të kohës së tij⁷.

Aradi është një personazh dhe ky romantik e sentimental⁸, te i cili ndodhin ndryshime të mëdha. Nga një njeri që di t'i kuptojë krejt ndryshe këto lloje marrëdhëniesh. Ky ndryshim ndodh së saje të dashurisë dhe lidhjes që pati me Bardhën, si dhe nga përfundimi i saj tragjik, si viktimë e paragjytimeve patriarkale.

Një personazh tjetër i rëndësishëm në roman është At Leonardi, shembull i klerikut që përpiqet për të mirën. Në të gjithë hapsirën që zë në roman , At Leonardi përhap mëshirën dhe zemërbardhësinë ⁹kristiane, duke u bërë një personazh mjaft i dashur gjatë leximit dhe mjaft funksional për subjektin dhe intrigën e romanit.

Vajza nga qyteti i Shkodrës është martuar në malësi me një bajraktar, Lulin. Kjo martesë është bërë me pëlqimin e prindërve, kuptohet pa fjalën e vajzës siç bëheshin në atë kohë martesat në Shqipërinë ishte shumë e zakonshme.

“Në Shqipëri nuk pyetet kurrë zemra e vajzave kur është fjala për martesën e tyre: kjo punë është në dorë të prindërve të tyre, dhe ata bëjnë si duan vetë. Të ankohesh apo të kundërshtosh vullnetin e tyre, kjo gjë do të ishte një krim, që një vajzë e ndershme nuk guxonte kurrë ta bënte.”¹⁰

Mirëpo, për Bardhën nuk ishte ashtu, ajo ishte martuar në një vend që ishte skëterrë për të ku nuk e donte askush sepse për kohën një martesë e një malësori me një vajzë nga qyteti nuk ishte zakon

⁷ Bardha e Temalit, Pashko Vasa, fq.16

⁸ Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Capaliku, Letërsia shqipe, fq.117

⁹ Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Capaliku, Letërsia shqipe, fq.118

¹⁰ Bardha e Temalit, Pashko Vasa, fq.34

“Me këtë martesë, Luli ishte bërë shkak që tërë fisi i tij ta qortonte rëndë. Askush nuk e kishte miratuar këtë punë, madje e kishin ndier veten të fyer, që trashëgimtari i prijësve të Temalit, duke bërë krushqi me njerëzit e qytetit, kishte hequr dorë nga përfitimet e një bashkimi më të përshtatshëm me vajzën e ndonjë prijësi malësor”¹¹. Për këtë arsye e urrenin vajzat e fshatit, vjehrra e saj e madje edhe vetë burri i saj nuk sillej me të si sillet burri me gruan. Ajo ishte e keqtrajtuar, e përbuzur, larg prej njerëzve të saj dhe grua e një njeriu që i kallte frikën.

Një ditë ajo merr leje nga burri për të vajtur në qytet te prindërit e saj. Atje e shoqëruar nga 100 malësorë i bëhet një pritje madhështore. Por gjatë ditës ndërsa malësorët pushonin granden një malësor dhe një Shkodran dhe vriten ndërmjet vete. Gjakmarrja ishte e ngulitur te shqiptarët në atë kohë.

“ Gjak për gjak. S’ka vend për hakmarrje. Ky borxh u la sipas zakonit. Natën e mirë”¹².

Me rëndësi ishte paguar gjaku, edhe pse ishin vlarë dy të rinjë. Në këtë jetë mjaft të brishtë kishte shumë pak vend për dashuri. Në këto rrethana jetonin shqiptarët të rrethuar nga vrasjet , konfliktet ndër fetare , padituria, të etur për luftë.

¹¹ Po aty, fq.30

¹² Po aty, fq.35

Haki Stërmilli lindi më 1895, në Dibër. Në vendlindje e kreu filloren dhe pjesërisht të mesmen, kurse gjimnazin e kreu në Manastir. Mbas kryengritjeve të viteve 1912-1913, në moshën 18 vjeçare, bashkë me shumë dibran, iku në Shqipëri, para egërsive serbe.

Ka punuar si nëpunës në administratën shqiptare, në Tiranë kreu detyra të rëndësishme në Ministrinë e Brendshme.

Më 1929 pushteti jugosllav ia dorëzoi Stërmillin pushtetit të Ahmet Zogut. U dënua me pesë vjet burgim, po edhe mbas burgut jetoi një jetë të vështirë. Nga viti 1943 Haki Stërmilli hyri në luftën kundër fashizmit në Shqipëri, duke marrë pjesë në operacione luftarake.

Mbas luftës Stërmilli ishte drejtues i pushtetit në Dibër, mandej drejtor i Bibliotekës Kombëtare, drejtor i Muzeut të Luftës dhe në kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve.

2.2. VEPRA E HAKI STËRMILLIT

Ky autor e nisi krijimtarinë letrare në vitet e '20 dhe shkroi deri në fund të jetës së vet. Shkroi prozë e drama, po ashtu prozë dokumentare dhe autobiografike. Trilogjinë¹³ e tij dramatike të viteve '20 e përbëjnë dramet: “Dibrania e mjerueme”, ”Dashuni e besniki” dhe “Agimi lumnueshëm”, që lidhen me ngjarje historike të Dibrës. Nga fusha e letërsisë dokumentare e autobiografike dallohen veprat : “Burgu e viteve '30” dhe “ Shtigjeve të lirisë” , e viteve '40 . Ky tip i shkrimit ka ndikuar më vonë edhe në letërsinë artistike të këtij autori.

Haki Stërmilli është i njohur në letërsinë shqipe me romanet:” Sikur të isha djalë” (1936) dhe “Kalorësi i Skënderbeut”, e shkruar më herët, por e botuar vetëm më 1967. Vecoria themelore e prozës së këtij autori është lidhja me temat sociale dhe mbështetja në ndjeshmëri sentimentale, në rastin e parë apo lidhja me temat e së kaluarës kombëtare në rastin e dytë. Autori gjithnjë kërkon një moral njerëzor në raportin në mes njerëzve në familje e në shoqëri.

Stërmilli bashkë me Spasen janë krijuesit e romanit social në letërsinë shqipe të viteve '30.

¹³ Sabri Hamiti, 2005, Letërsia modern shqipe, Prishtinë fq.132

Romani “Sikur të isha djalë” i Haki Stërmillit është shkruar në trajtën e ditarit, siç shkruhen shpesh romanet sentimentale apo letërsia autobiografike. [Kjo mënyrë shkrimi nxjerr në plan të parë shkruesin e ditarit, sforcon botëkuptimin e tij, kurse personazhet e tjerë janë në plan të dytë dhe ndërtohen në varsh mëri me pikëpamjet e krye personazhit.](#)fUSNOT Kopjim! Kështu ngjet me kryeveprën letrare të Stërmillit. Kjo vepër është romani i Dijes, më saktësisht ditari i saj, i shkruar në moshën 17 e 18 vjeçare dhe mban titullin Jeta ime. Pra është roman për një jetë, I rrëfyer në trajtën e ditarit intim.

Autori i del problem i pakalueshëm: sit ë rrëfëhet një jetë në të kaluarën, nëpërmjet një shkrimi nga dita në ditë që domosdo lidhet me të tashmen. Kjo duket në ditarin e Dijes kur përzihet koha e ngjarjes me kohën e shkrimit. Sidoqoftë, qenësinë e romanit Sikur të isha djalë e përbën tregimi për jetën e një femre shqiptare e rrëfyer nga ajo vetë. Kjo është një shtresë e veprës . Shtresa tjetër lidhet më tepër me domethënien shoqërore të veprës dhe të ideve, që projektton autori përmes saj.

Pra ,Brenda veprës rrëfëhet jeta e femrës shqiptare si dhe artikullohet ideja se si duhet të ndryshohet kjo jetë. Këto dy pika të kërkimit i referohen Dijes, një vajze me shkollë fillore dhe me jetë gjysmë të mbyllur. Shtrohet çështja e vërtetësisë, sa mundet një personazh me formim të tillë të përballojë idetë për ndërrimet shoqërore.Ka qenë shumë e vështirë që në kohën kur është shkruar vepra të bëhen ndryshimet në shoqëri shqiptare pikërisht nga një femër , ku dihet që femra nuk e ka pasur të drejten e saj as të shkollohet as të shpreh lirinë e saj të fjalës , nuk ka pasur të drejtë as ta zgjedh personin e zemrës, për të prindi është ai që merrë të gjitha vendimet e jetës.. Pra dhe personazhi femër Dija i krijuar nga Haki Stermilli del e pa fuqishme për ndryshimin e traditave shqiptare, ajo vë në theks të vecantë gruan shqiptare si një grua të emancipuar pa kurfar të drejte për të jetuar jetën e saj . Prandaj dhe personazhi kryesor Dija ka një ëndërr që ajo të jetë një djalë me qëllim që të jetë e lirë të shkollohet të jetoj jetën e saj sic do ajo sic e bënë një mashkull shqiptar i cili jeton lirinë e tij,në krahsim me gruan që është hermetike në të gjitha aspektet.

Kjo ka bërë që shkrimi i veprës në vend që të japë ngjarjet nëpërmjet ndjeshmërisë intime , teksti më shpesh kthehet në koment të ngjarjeve dhe në thirrje për ndërrimin e tyre, kurse ndjeshmëria intime përmbillet në klithmën sentimentale: “Oh sa fat I zi” apo “sa fatkeqësi”¹⁴.

Natyrisht, pjesa më e fuqishme e romanit është ajo që shtreson fatin e Dijes si femër shqiptare që jeton jetën e vet ndërmjet realitetit dhe ëndrrës. Tregimi i jetës së saj mund të përmbillet në fatin e lig ë jetimes në mëshirën e njerks së pashpirt, nevojën e rebelimit për të kaluar kufizimet e kësaj jete, kërkimin e dashurisë si e vetmja udhë e daljes nga letargjia e përgjithshme, dhe në fund humbja e dashurisë dhe vdekja nga sëmundja e pashërueshme . Në këtë vështrim Dija nuk është vetëm tregim i një fati njerëzor por edhe simbolizmi i një jete shoqërore. Pra, kërkohet dalja, bëhet përpjekja për ikje, por ikja nuk mund të realizohet. Në këtë mënyrë, në vend të veprimit të rebeluar, kemi flijimin sentimental siç ngjet në letërsinë e tillë.

Edhe tregimi i dashurisë, i dijës nuk ndërtohet sipas skemës së ndërhyrjes së personit të tretë, por sipas ndërhyrjes së kodit të dhunshëm të jetës. Lidhjen dashurore të Dijes me Shpendin nuk i prish personi i trete i dashur, por personi i tretë, burri, i cili hyn përdhunshëm në këtë raport, vetëm për të përshpejtuar vdekjen e Dijes, pra tragjedinë.

Raporti i ëndrrës së dashurisë dhe i realiteteve jetësore të Dijes merr fund me një frazë të saj: “Sot nuk jam më virgjëreshë”, që është frazë tragjike, sepse thuhet pasi është shtruar përdhunshëm në shtratin e burrit të zgjedhur përdhunshëm.

Raporti i saj me dy meshkujt fatalë të jetës së saj duket edhe në portretin që iu bën atyre. Për Shpendin, dashurinë e saj të madhe , Dija thotë: “Tip i çuditshëm dhe i përsosen. Një tip që ka bashkuar në vete bukurinë dhe egërsinë, ëmbëlsinë dhe ashpërsinë, butësinë dhe vazhdë sinë. i mbylla sytë që të mos e shoh, por nuk mbyllen sytë e mendjes e të zemrës , që ajo preku me një fuqi tërheqëse”. Kurse ne anën tjetër burrin e padëshirueshëm e përshkruan në këtë mënyrë: “ Një njeri gati 40 vjet, shtatmadh, mustaqeverdhë, turishëmtueshëm dhe i fuqishëm më rroku dje mbarma, dhe më. . . torturoi mizorisht dhe kafshërisht. Klithma, bërtita dhe ulërita deri sa u

¹⁴ fusnota

vilanisë, por ai nuk u përshtypja , nuk u zmbrops. Kur i mbylla sytë që të mos e shoh atë këlshedër, mu shfaq Shpendi para syve të mendjes”.

Pra, kush është Shpendi dhe pse nuk realizohet dashuria e tij me Dijen edhe pse të dy janë të gatshëm të rebelohen kundrejt zakoneve të kohës dhe të flijohen për njëri-tjetrin. Dija është vendëse, kurse Shpendi një Kosovar, që pas luftimeve me serbet ku humb babën dhe vëllezërit arrin në Shkodër që të vazhdojë shkollimin dhe të rimarrë jetën. i bukur, i mençur e u guximshëm, madje ideal në sytë e Dijës është i papëlqyer për babai e saj, pikërisht sepse është Kosovar dhe i huaj, pse nuk është tregtar dhe qyqar. Edhe prova e ikjes së tij bashkë me Dijën për Itali dhe dështimi i saj para policisë shqiptare, është një situatë përtej kohore që vizaton fatin e ëndërruesve të mëdhenj përballë konvencioneve pushtetarë. Vetë udha jetësore e Shpendit është tragjike: arratiset nga vendlindja, nuk mund ta realizojë dashurinë në Shqipëri, dhe kërkon shpëtimin në ikje të re, përtej botës shqiptare.

Shtresimi i dyte i romanit i detyrohet tepër ideologjisë së autorit rreth realiteteve të kohës dhe rreth kërkimeve për ndryshimin e këtyre realiteteve¹⁵ . Në këtë rrafsh të librit Dija është vetëm artikuluese e ideve të autorit, sidomos në vështrimet e saj për shoqërinë dhe ndërrimin e saj. Ky njësim idesh i autorit me personazhin, nganjëherë del kaq i plotë, prandaj edhe i çuditshëm. Vështrimet e Dijës, për kulturat, për mitologjitë popullore dhe për mitologjitë e të dhënat të kohëve të ndryshme, nuk duken reale dhe të bindshme në gojën e një 17-vjecareje të mbyllur në një provincë, një femre që nuk mund të sundojë kurrë sesi as fatin e vet, pra këtu del në skenë autori. Haki Stërmilli. Kurse figura e femrës për të kërkuar idetë e ndërrimit të pozitës së femrës shqiptare, i duket më e bindshme dhe më funksionale, në misionin humanitar të veprës së vet.

Në ngushticat e veta jetësore dhe shoqërore , kur ëndrrat i përplasnin nëpër realitet të kohës, personazhi Dija, mbrohet me klithmën Sikur të isha djalë. Kurse kërkimi i saj po të ishte djalë nuk shkon kurrë tutje kërkesës për të ndërruar pozitën e femrës shqiptare në shoqëri. Ka njerëz që këtë të dhënë e kanë parë si feminizëm, përkundrazi këtu ka të bëhet me kufizimin e një qenieje që nuk mund të shtrojë ide më të mëdha se sa mund të dalin nga njohja e jetës së saj konkrete në një

¹⁵ Sabri Hamiti, 2005, Letersia moderne shqipe, Prishtinë, fq.135

ambient konkret. Prandaj, thirrja e Dijës të isha djalë! Në të vërtetë është vetëm një thirrje utopike për një ndërrim utopik në botën shqiptare të kohës. Këtë e thotë edhe vetë realitetit i përshkruar në ditarin e saj. Çfarë bën për ndryshimin e shoqërisë, kushëriri i saj i dijshtëm, Hamiti apo çfarë bën më në fund vetë Shpendi, që është djalë, që është i dijshtëm e i guximshëm, që ka dashurinë e pafund për Dijën?

Në këtë vështrim, romani i Stërmillit, një roman me tezë, që shtron një utopi të ndërrimeve nëpërmjet gojës së një vajze të re, përfundon në një dëshpërim, në një ëndërr të shprishur. Aty vdes Dija, dhe aty vdes dashuria, kohën e tashme e sundon dhuna. Shpresat duhet të kërkohen në një kohë tjetër. Prandaj, romani i Stërmillit Sikur të isha djalë nuk mund të ngjitet përtej një veprë që shkon në hullinë e letërsisë sentimentale, në të cilin përshkruhet mjerimi shpirtëror nëpërmjet një gjuhe të pushtuar nga pasthirrat që shënjojnë dhembjet, por nuk mund t'i artikulojnë ato deri në fund. Vepra, në letërsinë tonë mbahet në mend më tepër pse në qendër të saj ka një personazh femre, pikërisht në veprën që shkruhet për ambientin ku femra, pikërisht në veprën që shkruhet për ambientin ku femra është një vështruese krejt pasive e rrjedhave jetësore. Në këtë kuptim autori e ngriti problemin e vet me mjeshtri, po me atë mjeshtri që e krijon personazhin e Dijës si krye personazh të parë të femrës në romanin shqiptar.

Romani i Stërmillit ka edhe vlerën tjetër, se rrok tema të shoqërisë së kohës, për dallim nga proza romanore e mëhershme shqipe, që rrok kryesisht tema të së kaluarës, të tipit atdhetar e heroik, të cilat mbështeteshin në anekdota ose në pseudo histori. Autori dëshmon se proza e romanit ka mundësinë që me sjelljen e fakteve të jetës t'i afrohet më shumë realitetit të kohës. Pra, që letërsia të rinjitet si rikrijuese e ambientit të vet autentik. Kjo është provuar me interesimin e madh për romanin Sikur të isha djalë i cili u ribotua dhe u bë vepër shumë e njohur dhe e lexuar nga brezat e ndryshëm për disa dhjetëvjetësha.

Mangësia në shprehje letrare është kushtëzuar edhe nga shkrimi i veprës si ditar i një femre. Pa marrë parasysh që shkrimtari njësohet me kërkesat e saj për ndërrime shoqërore, ai megjithatë në të shumtën në penën e saj nuk mund të hedhë një stil shprehjeje të përsosur, sepse do t'ia humbte autenticitetin. Në anën tjetër, vepra duke qenë e shkruar si ditar, madje si ditar që përpiket ta tregojë

edhe jetën kaluar, nuk jep veprime, por jep më shumë komente dhe rrëfime për të ndodhurat në të kaluarën.

Kundërvënia ndaj rregullave e ligjeve patriarkale fillon që me dëshirën e saj për të vajtur në shkollë, me përpjekje për të zgjeruar kulturën nëpërmjet librave, me protestën për të mos u mbuluar me ferexhe etj. Dashuria për Shpendi, të cilin e njohu rastësisht te shoqja e saj, megjithëse duket sikur ia zbukuron e ia pasuron jetën e mjerë prej jetimeje e prej vajze të mbuluar me ferexhe etj. Dashuria për Shpendin , të cilin e njohu rastësisht te shoqja e saj, megjithëse duket sikur ia zbukuron e ia pasuron jetën e mjerë prej jetimeje e prej vajze të mbuluar e ferexhe, kthehet në një tragjedi për të. Nga njëra anë dashuria e saj bëhet tepër dramatike për shkak të fantazimit të egër, izolimi brenda mureve të shtëpisë, nga ana tjetër , mungesa e ndonjë shprese se mund të bashkohej ndonjëherë me Shpendin ë kushtet kur për gjithçka duhet të vendoste i ati, i cili as që mendon se vajza mund dhe duhet të ketë ndjenjat dhe dëshirat e saj që duhen nderuar. Vendimi i tij për ta martuar Dijen me një burrë të moshuar, sepse është tregtar i pasur, e shkatërron përfundimisht jetës e saj.

“ Sot më vloi im atë me një farë Qazim Krandja, tregtar në shkallë të parë. Im At kishte shkuar në zyrën e Sheriatit dhe, si përfaqësuesi i fuqiplotë, kishte dhanë pëlqimin për kurorëzimin t’i me at far tregtari. Dhe kadiu pa pamë nevojë që të më pyeste se a e pëlqej këtë kurorëzim, i ban formalitet duke e bekue bashkimin t’onë ”¹⁶.

Gjithnjë e hajthme, e dobët, e trishtuar, e zhytur në mendime të zymta e menduar nga pamundësia për t’u takuar me të dashurin e saj Shpendin, dhe me parandjenja se gjithçka do të përfundonte keq, e fyer vazhdimisht nga njerka e saj, e fyer nga I ati, e papërfillur dhe e përbuzur nga shoqëria , ajo sëmuret rëndë nga tuberkulozi dhe vdes, pak kohë pasi e kanë martuar me përdhunë. Edhe përpjekjet e disa njerëzve me pikëpamje përparimtare të fisit të saj, edhe përpjekjet e Shpendit për ta rrëmbyer e për të kur nga Shqipëria dështojë. Fati i çdo vajze ishte përcaktuar, nënshtrimi dhe bindja ndaj ligjeve patriarkale, mbytyja e dëshirave dhe e dashurisë, ndryshe e priste turpërimi dhe asgjësimi fizik.

¹⁶ Sikur të isha djalë, Haki Stërmilli. Fq.123

“ Na sot jemi plotësisht si kafshët shtëpiake që vlejné vetëm për shërbime e nevoja shtëpie, jemi robnesha pa të drejtë mendimi e lirie, jemi kufoma të vdekurash që lëvizin si mbas shtytjes së meshkujve. Duhet të luftojmë në dacim të rrojmë si njerëz”¹⁷,

Shkruan Dija në ditarin e saj.

¹⁷ Sikur të isha djalë, Haki Stërmilli, Fq.166

Kapitulli II

1. ELEMENTE TË TRADITËS

Besa është me origjinë në lashtësinë iliro-arbërore, e ruajtur , e transmetuar në formën e saj të mirëfilltë brez pas brezi, është e shenjtëruar në institutin e besës kanunore. Fenomeni i besës ndër shqiptarë paraqet vlerat më sublimë etike, fetare, dokesore dhe shpirtërore, e njohur me fjalët: fjala e nderit, mbajtja e fjalës së dhënë, lidhja me fjalë, besnikëria, miqësia, pajtimi, vëllazërimi, solidariteti, falja, armëpushimi , mbrojtja, paqja. Fjala “besë”¹⁸ në Fjalorin e Gjuhës së sotme Shqipe është përkufizuar: “zotim solemn për të vepruar së bashku për një qëllim, fjala e nderit që jepet për të përkrahur dikë, ose për t’u lidhur me të” . Fjala e dhënë për diçka të rëndësishme, fjala e nderit për ta plotësuar me doemos një detyrim që merret përsipër.

Besa, ¹⁹si fenomen, është shumë i pranishëm në të drejtën zakonore dhe në traditën dokesore shqiptare, e posaçërisht në “Kanunin e Lekë Dukagjinit” të cilin, At Shtjefën Gjeçovi e kishte mbledhur dhe sistemuar nga goja e popullit dhe e kishte nxjerrë në dritë në vitin 1933. Gjeçovi me

¹⁸ Jani Thomai ,grup autorësh,2006, Fjalor i gjuhës shqipe Tiranë , Fq.85

¹⁹ Avdyl Hoxha, Rexhep Maksutaj, 2017, E drejta zakonore shqiptare, Prishtinë, Fq.398

këtë rast në kanun flet për besën si akt juridik, si normativ i ligjit ekzistues, edhe pse ishte një akt juridik i pashkuar, por që kishte mbijetuar nëpër shekuj me shumë e shumë shembuj.

Besa e shqiptarit zë një vend të rëndësishëm në kulturën dhe traditën tonë si akt moral. Shqiptarët kishin besën si mbrojtje dhe kur jepnin besën për një gjë ajo ishte akt i kryer. Këtë fenomen Pashko Vasa e ka trajtuar në veprën e tij “ Bardha e Temalit” ku autori vë në pah besën shqiptare. Anuli i jep fjalën Aradit se do ta bashkojë me Bardhën.

“-Po të betohem për miqësinë që kemi se, Bardha do të jetë gruaja jote.

-Gruaja ime? Si është e mundur kjo?- ia ktheu Aradi me sy të habitur.

Ajo do të jetë gruaja jote, po të them. Ajo do të jetë vejushë. Ja ku po ta përsërit, ajo do të jetë vejushë, ose unë nuk do të jem më në këtë botë. Po të betohem nesër do të nisem për në Pejë”²⁰.

Ai mundohet me çdo kusht ta mbajë atë fjalë që ka dhënë dhe niset për në Pejë për të vrarë Lulin, Me qëllim t’i bënte bashkë Aradin e Bardhën.

Ka edhe shembuj tjerë që vënë në pah traditën shqiptare. Aradi pasi kishte plagosur për vdekje Sylejman Cafin duke ikur nga rojet e Osman Agës futet në një shtëpi dhe kërkon besë. Në atë shtëpi është vetëm një grua , ajo e fut në shtratin e saj për ta mbrojtur por askush nuk guxonte t’i kontrollonte shtëpinë.

“-Kush je ti dhe çfarë kërkon këtu?- pyeti një zë gruaje e shtrirë në shtrat duke shtrënguar foshnjën e porsalindur në gji.

-Jam një vrasës, po më ndjekin dhe po lyp strehim në këtë shtëpi,-iu përgjigj Aradi me një zë të ëmbël që I dridhej,- të më shpëtosh me çdo kusht.

-ku të të fsheh pra?, ia ktheu lehona me zë të dëshpëruar. Eja nuk do të kapin nën shtratin tim”²¹.

²⁰ Bardha e Temalit, Pashko Vasa, Fq.275

²¹ Po aty, Fq.250

Ishte future pikërisht në shtëpinë e gjakësve të tij. i zoti i shtëpisë e ka për detyrë ta mbrojë me besën e vet këdo që i vjen në shtëpi dhe kërkon besë, kështu që sipas traditës ai e përcjell Aradin deri në një vend të sigurt dhe kur po ndaheshin i thotë këto fjalë:

“Njeriu që ti ke plagosur është kushëriri im. Ishte detyra ime të nxirrja shëndoshë e mirë nga shtëpia, por dije mirë, o Aradi i Vlashajve se pasi të kalojnë 24 orë po të takova do të të vras “²² .

Ky është zakoni i shqiptarëve edhe pse Aradi ishte armiku i tij, ai në shtëpi të vet nuk e vret as armikun dhe sipas zakonis e mbron atë.

Instituti i besës tek shqiptarët,²³ si një fjalë e dhënë edhe e mbajtur, që nënkuptonte besnikëri, mbështetje, siguri e sa e sa elemente tjera që respektoheshin me përpikëri qoftë kundruall shqiptarit ndaj shqiptarit, qoftë shqiptari ndaj armiku e mikut. Dhënia e besës ishte një institut aq i rëndësishëm sa ai që e jepte atë, kurë dhënësi ishte i qëndrueshëm e i pathyeshëm, ishte në gjendje të humbiste gjithçka, por jo edhe ta the atë. Besa definohet si “fuqi morale e teorisë dhe e vetëmohimit” që vështirë kuptohet nga të tjerët, e që vështirë e gjejmë te ndonjë popull tjetër.

Besa, mbajtja e fjalës së dhënë, përbën për kanunet tona, një autoritet të lartë ligjor, etiko-moral dhe politik. Të gjitha marrëdhëniet: në gjini, në fis, në famulli, në bajrak dhe në nivelin e bashkësisë etnike, madje edhe marrëdhënie ndëretnike, mbështeteshin në fjalën e dhënë. Për rëndësinë që ka besa në marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve, mjafton të kujtojmë shprehjen popullore: “ burri lidhet për fjale, kau për brirësh”.

Ka edhe shembuj të tjerë në këto vepra për të krahasuar por unë i zgjedha shembujt e përmendur më lartë për të treguar se për shqiptarët nuk ka rëndësi vdekja për ta kur është në pikëpyetje nderi e besa e dhënë, dhe nëse shqiptari e jep besën ai do ta mbrojë edhe me vdekje po të jetë nevoja.

Besa ka kuptim të gjerë te shqiptarët ajo përfshinë fjalën e dhënë si mikut, armikut, por edhe fjalën e dhënë për dashuri.

²² Po aty, Fq.250

²³ Avdyl Hoxha, Rexhep Maksutaj, 2017, E drejta zakonore shqiptare, Prishtinë, Fq.400

Pas një mosbesimi të Dijes ndaj Shpendit, ai i betohet për dashurinë apo i bën be:

*“Për shpirt të babës e të vëllezërve nuk due tjetër përveç teje o engjull- thirri
Shpendi me za të përvajshëm dhe më kapi për duersh.- Besomë se të due o shpirt!
Kij dhimë për mue”²⁴.*

Këto janë fjalë shumë të sinqerta të Shpendit, dhe këtu shihet se në çdo aspekt njeriu shqiptar e mban fjalën e dhënë.

Kanuni i maleve shqiptare nuk e veçonte “njerin prej njerit”. Nga kohëra shumë të hershme vjen përmes "E drejta zakonore shqiptare “ kulti i nderit. Nderi tek shqiptarët ndryshon nga kodet e kalorësisë evropiane të pragut të Rilindjes. Bëhet fjalë për një nder të ashpër, por dinjitar e madhështor në ashpërsinë e tij. Nderi dhe dinjiteti personal çmohen si vlerat shoqërore më të larta në shoqërinë e rregulluar nga “E drejta zakonore shqiptare”²⁵.

Këto vlera janë të trashëguara nga të parët dhe përbëjnë thesarin më të madh të transmetuar pasardhësve. Nderi nuk është kategori e ngurte e mbyllur në kornizat e etikës dhe të moralit të shoqërisë, madje ashtu si në poemat homerike, ku heronjtë kërkojnë të rrisin nderin e vet nëpërmjet lavdisë, apo të rivendosin nderin e përbaltur, kësisoj dhe DZSH (Kanuni i Lekë Dukagjinit) përcakton qëndrime e sjellje etiko-morale, që çojnë në lartësinë e nderit të individit, të familjes, të krahinës, të atdheut, ashtu si përmban dhe kritere ligjore, që e mbrojnë nderin.

Nuk duhet të çuditemi, por në shumë aspekte shoqërore, kategoria e nderit ka pësuar ndryshime. Kanuni i Lekë Dukagjinit fillon me nderin,²⁶ i konceptuar në dy kapituj: kreu i 17-të i dedikuar nderit vetjak, pra nderit të individit dhe në vazhdim kreu i 18-të trajton nderin shoqëror (te shoqërisë malësore). Nderi individual në Kanunin e Lekës shprehet si vlerë specifike , ndërsa në pozicionin shoqëror shndërrohet në një status me autoritet të madh, ose me autoritet të vogël, në varësi të respektimit, ose mosrespektimit të normave etiko-morale të shoqërisë, prandaj në malësi u ngrit në nivelin e nderit të shtëpisë dhe nderi i fisit.

²⁴ Sikur të isha djalë, Haki Stërmilli Fq. 102

²⁵ Avdyl Hoxha, Rexhep Maksutaj,2017, E drejta zakonore shqiptare, Prishtinë, Fq.348

²⁶ At Shtjefen Gjeçovi,Ofm, 2010 Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, Fq.65

Sjelljet subjektivisht të drejta, ose të përshtatura të individit në mjedisin familjar, ose shoqëror, sipas Kanunit bëhen veprime morale, pra janë shprehje e kodit moral në raportet ndërmjet individëve në familje dhe në shoqëri.

Te veprat që i jemi qasur për studim nderi gjithashtu zë një vend të rëndësishëm dhe autorët nuk e kanë lënë anash këtë akt moral. Tek të dyja veprat autorët përmendin nderin si akt moral i cili nuk duhet t'i cenohet asnjëri e në rast se cenohet nderi ai duhet të dënohet.

Te Bardha e Temalit autori përmes një historie të vogël na tregon se si dënohet ai që guxon t'ia prek nderin një familje apo personi. Mhilli i Vlashajve kishte pasur një vajzë të cilën e kishte vrarë për shkak se e kishte "çmendur". Mhilli pasi kishte parë që në kopshtin e tij një djalë i ri i shfaqte dashurinë vajzës së tij ishte tmerruar:

*"-Jemi ç'nderuar. Isha në kopsht dhe kapa në faj e sipër bijën tonë me Topiajn e ri. E pashë sheshit ç'nderimin tonë. Nesër Topia nuk do të jetë gjallë. Ti e di se ç'duhet të bëjë bija jonë... pas kësaj që ndodhi ajo nuk mund të jetoj më. . . "*²⁷.

Dhe të nesërmen Mhilli vret Topiajn e ri ndërsa gruaja e tij e helmon të bijën për shkak të ç'nderimit që i ka bërë ajo familjes.

Po ashtu edhe në veprën "Sikur t'isha djalë", kemi një rast të ngjashëm të "çnderimit",

*- "Nji katundar kishte vramë të bijën, pse ajo qenka dhunue me nji fshatar .Në fund të gjithë dhe nji zanit e përhiruen atin që e kishte vramë të bijën. Me fjalë tjera femna e dhunume u gjykue si fajtoe e pafalshme dhe u dënue me. . . vdekje"*²⁸.

Këtu Dija këtë akt e komenton si shenjë proteste në ditarin e saj, babai e kishte vrarë të bijën pafaj.

Në këta shembuj mësojmë se nderi të shqiptarët ka qenë dhe akoma mbetet një institut me vehte nëse mund të themi, dhe se nuk duhet cenuar. Mirëpo, për fat të keq shpeshherë nuk është trajtuar si duhet dhe kaq pësuar njerëz pa faj në emër të ndershmërisë.

²⁷ Bardha e Temalit, Pashko Vasa. Fq. 104

²⁸ Haki Stërmilli. Sikur të isha djalë, Fq. 117

Kanuni kërkon barazi para ligjit dhe zbatimin me përpikëri të ligjeve të çdo kohe si domosdoshmëri e jetës, nënshtrimin ndaj rregullit në komunitet nga prijësi deri tek më i thjeshti, dhënien e drejtësisë dhe ndëshkimin e rreptë ndaj krimit.

-Gjaku për gjak me mbetë, thotë Kanuni.

Pse në traditën tonë dhe e përcjellë edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ku cekim edhe rastet e vrasjes, kur ngjanë ta vrasë shoqi shoqin, e në këtë rast vriten që të dytë, mesin krye për krye, ose në këtë rast gjak për gjak²⁹. Shtëpitë e të vrarëve nuk mund të shtyhen një fjalë, as nuk mund të lypin shpërblime familja apo lagja familjes e lagjes tjetër. Do të dorëzonin si mbas Kanunit dhe traditës shqiptare .

Në rast, po mbet njani i vramë e tjetri i plagosur, atëherë i plagosuri ka obligim ta kthejë gjysmën e çmimit të gjakut të vrami. Më poshtë është dhënë shembulli i gjakmarrjes gjak për gjak.

Te vepra “Bardha e Temalit” hasim mjaft shpesh në akte të tilla të gjakmarrjes. Me rastin e vrasjes së dy të rrënjëve në Shkodër, ku të dy vriten në të njëjtën kohë ja si shprehet nëna e malësorit të vrarë ;

“Kuku! E zeza unë, që s’kam djalë tjetër që t’i marrë gjakun. Gjaku i tij do te humbë nëse fisi na kia merr”³⁰ .

Po kur merr vesh se edhe djali i saj në të njëjtën kohë e kishte vrarë dorasin e tij ajo shprehet në këtë mënyrë;

“- Zoti qoftë I lëvduar! Humba djalin e fundit, loqkën e zemrës sime, por, të paktën, nuk do të thonë se nuk I është marrë gjaku. Jo! Gjaku për gjak, vdekje për vdekje !”³¹

Ja pra , kjo ishte gjakmarrja. Nëna e mjerë nuk vajtonte për djalin e vrarë, por qante se kishte frikë se nuk do mund t’ia merrte gjakun të birit, edhe pse të tre bijtë e saj kishin vdekur në këtë mënyrë.

²⁹ At Shtjefen Gjeçovi, Ofm, 2010, Kanuni I Lekë Dukagjinit, Shkodër, Fq.86

³⁰ Bardha e Temalit, Pashko Vasa Fq.50

³¹ Bardha e Temalit, Pashko Vasa Fq.64

Pastaj vrasja e Jak Kolës nga pushteti ishte mjaft i vrazhdë. Tek ai autor na paraqet tiparet e një trimi shqiptar të etur për luftë.

“-Bijtë e aleve tona mbarojnë gjithmonë nga shpata ose nga plumbi”³².

Atë në burg e vizitojnë e ëma me të shoqen duke iu betuar se do t’ia marrin gjakun.

“Ja ku më ke , o bir. Erdha me tët shoqe për lamtumirën e fundit. Meqë duhet të vdesësh, biri im I dashur, pajtohu me fatin dhe vdis si trim, ashtu sit ë parët e tu. Jot shoqe dhe unë që po na lë përgjithmonë, po të betohemi se gjakun tënd do ta marrim”³³ .

Nga këta shembuj shihet se shqiptarët e kishin të ngulitur thellë në mendjet e tyre gjakmarrjen dhe ishte e vështirë ta harronin këtë akt. Madje edhe gratë ishin të afta të bënin këtë punë në një mënyrë apo tjetrën. Gruaja e Jek Kolës paguan njeriun për ta marrë hakun e të shoqit. Paguan plakun Gjeto, shërbëtorin besnik të Mhillit të Vlashajve.

“Kam nevojë për një punëtor që të më ndihmojë të vrasë një njeri, I cili më ka borgj një gjak, dhe mendova për ty. A po bëhesh punëtori im, Gjeto? Po t’i jap që tani dhjetë fishekë dhe pesëqind piastre, pasi të kesh mbaruar punë.”³⁴ ”

Ashtu si ndodh rëndom në shumë vepra të shkrimtarëve të mëdhenj që e kanë analizuar me mjeshtri pasionin e dashurisë, duke depërtuar deri në skutat më të errëta të shpirtit të njeriut, edhe në romanin “Bardha e Temalit” dashuria e vërtetë, ajo dashuri që zhuri zemrat dhe lë gjurma të pashlyeshme, është e paracaktuar nga vula e një fati të çuditshëm. Autori shpreh haptas botëkuptimin e tij idealist për dashurinë, sepse , si thotë dashuria ideale “lind e ushqehet me

³² Bardha e Temalit, Pashko Vasa Fq.65

³³ Po aty, Fq. 145

³⁴ Po aty, Fq. 147

ëndërrime e shpresë, ajo magjepsë njeriun duke e bërë të vuajë, e bën të jetojë duke ia sjellë vdekjen, fisnikëron shpirtin duke pastruar zemrën³⁵.”

E konceptuar në këtë mënyrë, dashuria e Bardhës dhe e Aradit është një lloj sublimacioni i kësaj ndjenje fisnike, pa të cilën jeta jonë do të ishte shumë më e varfër dhe jo kuptimplote. Dashuria e krye protagonisteve të romanit është ngjarje e pazakonshme në këto rrethana, por edhe dëshmi se natyra e njeriut në thelb mbetet e pandryshueshme se Tristanët e Izotat, ose Romeot dhe Gjulietat I ngjajmë gjithkund dhe në çdo kohë. Dashuria midis Aradit e Bardhës është deri diku fluide, e pakapshme, e paraqitur në atë mënyrë si e përjeton njeriu I cili pa prituri e pa kujtuar bien ë kthetrat e saj, nga të cilat s’ka fuqi që mund ti lirojë. Megjithatë, me rastin e analizës së krye protagonistes së romanit nuk duhet harruar as faktin se Bardha jeton në një ambient specifik, se ajo nuk e ka në dorë fatin e saj dhe se është më shumë një lodër së duar e të tjerëve. Përveç kësaj Bardha paraqitet vetëm në relacionin e dashurisë së saj ndaj Aradit. Aspektet e tjera të jetës së këtij personazhi janë anash, ngase në të vërtetë asgjë nuk ndodh në jetën e kësaj gruaje para se të takohet me Aradin, ditët e saja ishin të zbrazëta, monotone, dëshirat të ndrydhura në një shoqëri primitive.

Po ashtu edhe te Haki Stermilli në veprën “Sikur të isha djalë” tema për dashurinë ka qenë e pranishme sidomos te krye protagonistet e veprës Dija dhe Shpendi që dashurojnë marrëzisht njëri tjetrin mirëpo fati nuk iu buzëqesh aq sa duhet, fati I keq që e ndjek Dijen nga i ati i saj dhe njerka, atë e shtyn nga një tjetër rrugë ajo pëson në dashuri. Dashuria midis personazheve e ka qenë një dashuri e pastër dhe bujare e cila nuk vazhdon shumë gjatë me lumturi mirëpo vetëm me të këqija, pas një kohe vendosin ta martojnë prindërit Dijen me një tregtar të cilën ajo as që e njihnte duke ia përmbysur kështu botën e saj. Vendosë të ikë bashkë me Shpendin jashtë shtetit.

“ E bana gati përgjigjen dhe I thashë se jam gati me shkue, me te, edhe në fund të ferit. Gjithashtu i thashë se në mos mundshim mu arratisë, kam vendosë me vra vehten mu n’at çast që do të shkel në prak të derës së atij tregtarit dhe nuk do të pranoj me u bamë grueja e tij.³⁶”

³⁵ Pashko Vasa, Bardha e Temalit, Fq. 44

³⁶ Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Fq.130

Mirëpo, tentim për arratisje dështon , dhe asaj ve qesë i përkeqësohen gjërat, po ashtu edhe shëndeti. Dija çdo ditë e më shumë bëhet edhe më keq, ajo vdes nga një sëmundje duke shkruar deri momentet e fundit në ditarin e saj për jetën e vet dhe për të dashurin e saj Shpendin.

Por ajo që dua t'i vë theks të veçantë në këtë pjesë të studimit tim është pikërisht roli i traditës. Sa ka ndikuar tradita, në këto tragjedi , në këto tragjedi, ligjet zakonore të shqiptarëve. Po të mos i pengonin zakonet e rrepta të vendit sigurisht që këto çifte të dashuruarish do të ishin të lumtur dhe nuk do të kishte aq shumë vrasje dhe pikërisht zakonet kanë ndikuar të ndodhin gjëra të tilla. Femra shqiptare në atë kohë ka qenë shumë e shkelur dhe e pafuqishme për të ngritur zërin për të drejtën e saj pikërisht këto të drejta që i gëzon çdo njeri që nga lindja zakoni ishte ai që ua mohonte dhe ishin fare të pafuqishme ndaj atyre ligjeve të rrepta . Ato vetëm duhet të përulëshim para tyre dhe gjithçka varej nga fati. Vajza shqiptare nuk kishte të drejtë të dashuronte , të shkollohej . . . prindi ishte ai që vendoste për fatin e saj. Andaj vajza duhej t'i bindej me përulësi dhe të jetonte ashtu si i shkruhej fati i saj nga të tjerët. Haki Stermilli nëpërmjet personazhit të Dijës me zë proteste kërkon emancipimin e femrës shqiptare, gëzimin e lirive të saj. . .

“Lypset të ngemë krye duhet të çohemi peshë e t’i luftojmë këto ligje e zakone që na i grabisin të drejtat t’ona ma se natyrale, që na poshtojnë e na ulninë shkallën e një robneshe së neveritun, që na i shkollojnë dhe na i shterrin burimet e sedres e të krenarisë si femna e si njerëz që na shtypin pamëshirshëm”³⁷.

³⁷ Po aty, Fq. 119

Kapitulli III

ANALIZA E TË DHËNAVE

Për ta plotësuar analizën sasiore të kësaj teme, është krijuar pyetësi, përmes të cilit, është marrë mendimi i nxënësve, të cilët, këto dy vepra i kanë pasur pjesë të plan programit mësimor në lëndën e Gjuhës shqipe.

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë 55 nxënës të klasave të 11-ta të Shkollës së Mesme SHMLM “Kongresi i Manastirit” në Pozheran. Nga ta, kanë qenë femra 29 dhe 26 meshkuj. Në këtë pyetësor është tentuar të merren përgjigje nga nxënësit rreth asaj se si traditat shqiptare kanë pasur rol të rëndësishëm te populli shqiptar e në veçanti për femrën shqiptare se si ajo ka ndryshuar nëpër kohë, emancipimi i gruas shqiptare e pikërisht kjo temë është trajtuar te veprat “Bardha e Temalit” dhe “Sikur të isha djalë”.

Pyetësi ishte jo shumë i gjatë dhe i koncentruar ne elementet kryesore qe vënë në pah elementet e traditës shqiptare te përshkruar ne veprat e elaboruar ne këtë punim dhe kam analizuar përgjigjet ne këto pyetje:

1. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë ndikuar tek unë për ti kuptuar më mirë tradita shqiptare.
2. Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" më është shtuar ndjenja për të lexuar më shumë për traditat shqiptare.
3. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë emancipimin e gruas shqiptare ndër vite.
4. A ka ndryshuar roli i gruas shqiptare te "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" me atë të ditëve të sotme?
5. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë pasur rol edukativ tek unë?

Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kam fituar bindjen se...

- a.Traditat shqiptare janë ato që kanë ndikuar në emancipimin e gruas shqiptare
- b.Traditat shqiptare nuk kanë pasur ndikim në emancipimin e gruas shqiptare
- c.Traditat shqiptare e kanë shty që gruaja shqiptare të ndikohet nga tradita

A mendoni se traditat shqiptare po harrohen dhe duhet ti kultivojmë më shumë ato ??

6. Te veprat “Bardha Temalit” dhe “Siku të isha djalë” traditat shqiptare i kemi trajtuar si temë mësimore në shkollë
7. Veprat "Bardha e Temalit" dhe Siku të isha djalë” kanë ndikuar pozitivisht për ndryshimin e traditave shqiptare .
8. Veprat "Bardha e Temalit dhe "Siku të isha djalë” kanë ndikuar që të kuptoj ndryshimin e traditave shqiptare nëpër kohë.

Më poshtë janë paraqitur rezultatet e pyetësorit në fjalë në formë grafike dhe tekstuale.

Pyetja 1. *Veprat 'Bardha e Temalit' dhe "Siku të isha djalë" kanë ndikuar tek unë për ti kuptuar më mirë tradita shqiptare*




Figura 1 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Nga pyetja e parë e pyetësit të zhvilluar me nxënësit rezulton se 78.9% e nxënësve janë pajtuar se veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë ndikuar për t`i kuptuar më mirë traditat shqiptare. Numri i atyre që janë pajtuar pjesërisht kanë qenë 13%, një përqindje e vogël janë përgjigjur që nuk janë të sigurte (rreth 6.5 %) dhe krejt në fund ata që nuk janë pajtuar përbëjnë një përqindje fare të vogël në përgjigjet pranuar.

Pyetja e 2. Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" më është shtuar ndjenja për të lexuar më shumë për traditat shqiptare.




Figura 2 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Nga pyetja e dytë më është shtuar ndjenja për të lexuar më shumë për traditat shqiptare janë përgjigjur që 60.5% janë pajtuar . Ata të cilët janë pajtuar deri diku përbëjnë 31.6 % dhe ata të cilët nuk kanë qenë të sigurtë. Opsionin ‘nuk jam i/e sigurt’ është një përqindje e vogël .

Pyetja 3. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë “ kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë emancipimin e gruas shqiptare ndër vite.




Figura 3 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Me pyetjen e tretë se si kanë ndikuar për të kuptuar më mirë emancipimin e gruas shqiptare ndër vite janë pajtuar 78.9%. Ata ose ato që janë pajtuar deri diku janë 10.5%. Ata ose ato të cilët janë përgjigjur nuk jam i/e sigurt dhe nuk pajtohem janë një përqindje e vogël.

Pyetja 4. A ka ndryshuar roli i gruas shqiptare te "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë ” me atë të ditëve të sotme.




Figura 4 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Në pyetjen e katërt se a ka ndryshuar roli i gruas shqiptare me atë të ditëve të sotme, janë pajtuar 54.1% janë pajtuar deri diku 32.4%, nuk kanë qenë të sigurtë 10.8% dhe nuk janë pajtuar një përqindje shumë e vogël.

Pyetja 5. Veprat "Bardha e Temalit dhe "Sikur të isha djalë" kanë pasur rol edukativ tek unë.




Figura 5 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Në pyetjen e pestë se a kishin pasur rol edukativ këto vepra tek ta janë pajtuar 50%, janë pajtuar deri diku 28.9%, nuk kanë qenë të sigurt një numër i vogël i përqindjes dhe nuk janë pajtuar është 13.2%.

Pyetja 6. Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kam fituar bindjen se...




Figura 6 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Në pyetjen e gjashtë nëse nga këto vepra kishin fituar bindjen se: Traditat shqiptare janë ato që kanë ndikuar në emancipimin e gruas shqiptare, si alternativë të parë e kanë zgjedhur 56.8%, alternativën e dytë traditat shqiptare nuk kanë pasur ndikim në emancipimin e gruas shqiptare e kanë zgjedhur një përqindje e vogël, ndërsa alternativën e tretë traditata shqiptare e kanë shty që gruaja shqiptare të ndikohet nga tradita e kanë zgjedhur 27% alternativat tjera kanë qenë me numër të vogël .

Pyetja e 7. A mendoni se traditat shqiptare po harrohen dhe duhet ti kultivojmë më shumë ato??




Figura 7 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI

Në pyetje e shtatë, se a mendonin nxënësit se traditat shqiptare po harrohen dhe duhet ti kultivojmë më shumë ato, janë përgjigjur me ndoshta pak 55.3%, me Po janë përgjigjur 39.5%, ndërsa me Jo janë përgjigjur një numër i vogël.

Pyetja 8. Te veprat “Bardha Temalit” dhe “Siku të isha djalë” traditat shqiptare i kemi trajtuar si temë mësimore në shkollë.




Figura 8 Rezultatet nga pyetësori i plotësuar nga nxënësit e klasës XI

Në pyetjen e tetë a mendojnë që traditata shqiptare I kanë trajtuar si temë mësimore në shkollë me pajtohem janë 76.3% me pajtohem deri diku 10.5% opsionet tjera janë me përqindje të vogla .

Pyetja 9. Veprat "Bardha e Temalit" dhe Siku të isha djalë” kanë ndikuar pozitivisht për ndryshimin e traditave shqiptare .




Figura 9 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Në pyetjen e nëntë se a kanë ndikuar pozitivisht për ndryshimin e traditave shqiptare janë pajtuar 42.1% pajtohem deri diku 28.9% nuk jam i/e sigurt me 13.2% po ashtu me nuk pajtohem 13.2%.

Pyetja 10. Veprat " Bardha e Temalit dhe "Siku të isha djalë" kanë ndikuar që të kuptoj ndryshimin e traditave shqiptare nëpër kohë.




Figura 10 Rezultatet nga pyetësi i plotësuar nga nxënësit e klasës XI.

Në pyetjen e dhjetë se a kanë ndikuar që të kuptojnë ndryshimin e traditave nëpër kohë janë përgjigjur me pajtohem 73% me pajtohem deri diku 10.8% , nuk jam i/e sigurt 13.5% me nuk pajtohem një numër i vogël i përqindjes.

PËRFUNDIME

Objektivi kryesor i kwtij punimi ka qenë kryerja e një vlerësimi të veprave "Bardha e Temalit" të Pashko Vasës dhe "Sikur të isha djalë" të Haki Stërmillit, me përqëndrim të veçantë trajtimin e

traditave shqiptare në to. Kam qenë e befasuar për të mirë se si nxënësit gjatë leximit të veprave kan arritur ti perceptojnë aq mirë traditat shqiptare për mes romaneve “Bardha e Temalit” dhe “Sikur të isha djalë”, po ashtu ka pasur një ndikim efektiv tek ta për ruajtjen e vlerave shqiptare që i kemi trashiguar brez pas brezi dhe duhet të jemi krenare me to, një ndër traditat shumë vjecare, është mikëpritja e ngrohtë dhe bujare e mysafirit. Nderi dhe rrespekti që ja përkushtojm mysafirit, që nga ardhja e tij në shtëpinë tonë, e deri tek largimi i tij nga shtëpia e jonë, tregon dukshem, bujarinë, fisnikrinë, dhe zakonet e shqiptarit. Kemi dhe shumë vlera tjera për traditën shqiptare mirëpo ne i përmendim vetëm disa nga ato... Këto vepra janë analizuar dhe kritikuar nga autorë të njohur kritikë lidhur me këtë çështje

Në pyetjen kërkimore *Sa i është dhënë rëndësi e vecantë traditave shqiptare nga autorët Pashko Vasa dhe Haki Stërmilli në veprat “Bardha e Temalit” dhe “Sikur të isha djalë”* është bërë një analizë sasiore duke u mbështetur në kritikën ekzistuese për këta autorë të njohur, në veçanti kritikën rreth veprave të tyre që janë trajtuar në këtë punim

Pyetja e dytë kërkimore ishte *Në këto vepra a kanë ndikur traditat në ruajtjen e vlerave të vjetra tek nxënësit e shkollës së Mesme?*

Për t'i nxjerrë këto rezultate, është zhvilluar një pyetësor me nxënësit e SHMLM "Kongresi i Manastirit" për të mbledhur të dhëna se si dhe në çfarë mase këto vepra letrare kanë ndikuar në qëndrimet dhe pasqyrimet e tyre për traditat shqiptare. Të dhënat e përgjithshme kane treguar se 62.8% e të anketuarve ishin pajtuar ose pjesërisht u pajtuan, ndërsa vetëm një numër i vogël prej 3.22% zgjedhën opsionin që shpreh mospajtim me pyetjet e bëra në pyetësor. Pjesa e mbetur prej 33.97% zgjedhi 'Nuk jam i sigurt'. Për rrjedhojë, këto përqindje sugjerojnë një përgjigje solide të studentëve që ishin pajtuar me pyetjet e parashtruara.

Rezultatet e këtij studimi mund të shërbejnë për studiuesit e folklorit dhe traditave kombëtare, për antropologët dhe prindërit, për të bartur dhe mbajtur gjallë këto tradita tek gjeneratat e ardhshme. Për më tepër, kjo temë e magjistraturës mund të ofrojë të dhëna shtesë për të kuptuar se si veprat letrare që trajtojnë tema që kanë në fokus traditat kombëtare mund të shërbejnë si një mjet për të ngritur vetëdijen për ruajtjen dhe kultivimin e këtyre traditave.

Po ashtu gjatë studimit tim për temën Elemente të traditës në veprat “Bardha e Temalit” e Pashko Vasës, “Sikur të isha djalë” e Haki Stërmillit, kam arritur në përfundim se këto vepra janë bërë mjaft të popullarizuar dhe janë bërë pjesë e përhershme e lëktyrave shkollore, mirëpo në të gjitha interpretimet që ka pasur për këto vepra janë përqendruar më shumë në analizën e tyre, ndërsa unë i jam çasur në një mënyrë tjetër.

Bardha e Temalit është ndër romanet e parë në letërsinë shqipe dhe normal që ka mangësitë e veta. Autori i këtij romani nuk ka qenë objektivist, ai krahas temës kryesore dashurisë I ka vënë për detyrë të paraqesë edhe jetën shoqërore shqiptare me të gjitha virtytet dhe veset e saj. Ai paraqet edhe doket e zakonet e shqiptareve, mikpritjen, besën por edhe gjakmarrjen, problemet fetare, pra ai përveç të mirave, paraqet edhe të këqijat që e kanë brengosur shkrimtarin.

Haki Stërmilli në veprën Sikur t’isha djalë nëpërmjet ditarit të Dijës na shpalos pamje nga jeta shoqërore shqiptare dhe me këndvështrimin e një vajze ai tregon vuajtjet, cenimin e të drejtave të tyre nga shoqëria e së par nga prindërit e tyre. Ajo në këtë ditar kërkon të përmirësojë gjendjen në femrës apo pozitën e saj në familje në shoqëri etj.

Nëpërmjet shënimeve të saj lexuesi njihet me jetën e përditshme të një familjeje të zakonshme qytetare shqiptare, ku ndihet edhe prapambetjet e theksuar shoqërore, edhe pozita e mjeruar e gruas në familje, e cila duhet të bëjë një jetë të mbyllur Brenda mureve të shtëpisë e sipas ligjeve patriarkale. Bota shpirtërore, ndjenjat dhe dëshirat e saj duhet të ndrydhen e të shuhen, ndryshe shfaqja e tyre shkakton skandal në familje dhe në shoqëri, të vendosë burri. Kështu, ajo është një skllave, që duhet të lindë fëmijë të cilët do të bëhen përsëri viktimë e këtyre ligjeve të egra sunduese në shoqërinë shqiptare të viteve ’30.

Shpresoj që sadopak t’ia kem arritur qëllimit që ia kam shtruar vetes në fillim duke studiuar elementet e traditës shqiptare që hasim në këto vepra siç janë : nderi, besa, gjakmarrja, mikpritja shqiptare etj, Elemente këto që disa kanë pasur ndikim të mirë e disa ndikim jo të mirë në jetën e shqiptarëve dhe në realizimin e aspiratave të tyre.

Literatura

1. Pashko Vasa “Bardha e Temalit” Rilindja , Prishtinë 1990
2. Haki Stermilli “Sikur të isha djalë” Dija, Prishtinë 2019
3. Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, Albas, Tiranë 2006
4. Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Capaliku “Letërsia shqipe për klasën e dytë të shkollave të mesme” Libri shkollor 2000, Prishtinë
5. At. Shtjefën Gjecovi ”Kanuni i Lekë Dukagjinit” Botime Franceskane, Shkodër, 2010
6. Avdyl Hoxha, Rexhep Maksutaj “ E drejta zakonore shqiptare” (Trashëgimi kulturore-Juridike),Faik Konica, Prishtinë, 2017
7. Jani Thomai, Mico Samara, Pavil Haxhillazi, Hajri Shehu, Thans Feka, Valter Memisha, Artan Goga, Fjalor i Gjuhës Shqipe , Akademia e Shkencave , 2006
8. Letërsia moderne shqipe , Albas, Prishtinë, 2005
9. Sabri Hamiti , Studime letrare, Botime të veçanta XLIX seksioni i gjuhës dhe letersisë shqipe, Prishtine ,2003

ANEKSI 1 Pyetësor për temën e Masterit

I/e nderuar nxënës/e,

Ju lutem t'i ndani pak minuta nga koha e juaj për t'më ndihmuar me këtë pyetësor me përgjigjet e juaja që kanë të bëjnë me veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë"

-Pyetësori është plotësisht anonim dhe nuk ka nevojë ta shënoni emrin tuaj. Rezultatet e tij do të përdoren vetëm për temën time të Masterit.

-Pyetësori përmban 10 pyetje, kryesisht të mbyllura.

-Pyetësori parashihet se merr vetëm rreth 2-4 min. për t'u plotësuar.

Ju falënderoj shumë për kontributin tuaj!

Xhemile Selmani-Syla

1. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë ndikuar tek unë për ti kuptuar më mirë tradita shqiptare.

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

2. Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" më është shtuar ndjenja për të lexuar më shumë për traditat shqiptare.

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

3. Veprat "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë emancipimin e gruas shqiptare ndër vite.

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

4. A ka ndryshuar roli i gruas shqiptare te "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" me atë të ditëve të sotme?

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

5. Veprat "Bardha e Temalit dhe "Sikur të isha djalë" kanë pasur rol edukativ tek unë?

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

6. Pas leximit të veprave "Bardha e Temalit" dhe "Sikur të isha djalë" kam fituar bindjen se...

Traditat shqiptare janë ato që kanë ndikuar në emancipimin e gruas shqiptare

Traditat shqiptare nuk kanë pasur ndikim në emancipimin e gruas shqiptare

Traditat shqiptare e kanë shty që gruaja shqiptare të ndikohet nga tradita

7. A mendoni se traditat shqiptare po harrohen dhe duhet ti kultivojmë më shumë ato ??

PO

Ndoshta pak

JO

8. Te veprat "Bardha Temalit" dhe "Siku të isha djalë" traditat shqiptare i kemi trajtuar si temë mësimore në shkollë

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

9. Veprat "Bardha e Temalit" dhe Siku të isha djalë" kanë ndikuar pozitivisht për ndryshimin e traditave shqiptare .

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem

10. Veprat "Bardha e Temalit dhe "Siku të isha djalë" kanë ndikuar që të kuptoj ndryshimin e traditave shqiptare nëpër kohë.

Pajtohem

Pajtohem pjesërisht

Nuk jam i/e sigurt

Nuk pajtohem